



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 25, datë 26.02.2018**

**PËR**

**PEZULLIMIN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË SI VLERËSUES**  
**DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**KONSTATOI SE:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 226 e vijues, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, licencën dhe mbikëqyr vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Z. Sabri Hoxha është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve shëndetësore sipas licencës nr. 115, datë 30.06.2015.

Mbikëqyrja e veprimtarisë së këtij vlerësuesi është bërë nëpërmjet shqyrtimit të akteve të vlerësimit, për të cilat është depozituar ankesë nga shoqëritë e sigurimit.

Referuar disa ankesave të depozituara pranë AMF-së, janë konstatuar disa raste të shkeljeve të kryera nga ana e vlerësuesit të dëmeve z. Sabri Hoxha. Këto vlerësime janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që

mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar. Zbatimi i gabuar i ligjit dhe rregullores kanë sjellë si pasojë një vlerësim jo real të dëmit.

Gjithashtu, në aktet e vlerësimit të depozituara, konstatohet se llogaritja e dëmit jo pasuror është bërë nga ky vlerësues me dy metoda, në kundërshtim me nenet 230 dhe 233 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ku përcaktohet se:

*Vlerësuesi i dëmeve, në vlerësimin e dëmeve, i referohet treguesve dhe koefiçentëve, të nxjerrë nga institucionet kompetente, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe vlerësuesit e dëmeve duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.*

Në këto kushte, Autoriteti me shkresën nr. 247/3 prot., datë 07.02.2018, ka vënë në dijeni vlerësuesin e dëmeve z. Sabri Hoxha, mbi fillimin e procesit të marrjes së masave administrative, të parashikuara në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe në Rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë të vlerësuesit të dëmeve në sigurime”.

Përsa më sipër, duke qenë se vlerësuesi ka bërë vlerësime që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe nuk ka respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

#### **V E N D O S I:**

1. Bazuar në pikën 3, të nenit 228 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe bazuar në pikën 2 të nenit 10, të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë të vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, pezullimin e licencës së vlerësuesit të dëmeve shëndetësore në sigurime z. Sabri Hoxha, për një periudhë kohore 6 muaj.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**